Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: 1. Autoriteti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën e prokurimit të pavlefshme.

2. Autoriteti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.
3. Autoriteti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:
 - (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
 - (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
 - (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[**Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit**]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

LOTI 1: “SHËRBIM DHE MIRËMBAJTJE E KONDICIONERËVE PËR SALLAT E SERVERËVE TË TI-SË NË MINISTRI DHE ZYRAT E DTI-SË”

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

C	Kondicioner 60kBTU, tip “Kolonë IdealClima”	Cope 1	Të dhënat e Kondicionerit: • Emërtimi: Kondicionerë tip “Kolonë” • Prodhimi: Idealclima • Tensioni i punës: 220-240 V AC • Kapaciteti në ftohje: 60000 BTU/h $\approx$ 16kw • Lloji I gazit: R410a
----------	--	--------	--

[illegible]

			• Frekuenca: 50 HZ • Rrjedhja e ajrit brenda njësisë: më e madhe se 2000–2600 m³/h • Vendodhja: Instaluar në sallën TI të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Pjesë Këmbimi per kondicionerin: • F.V. Kondenstator kompresori, 1 copë • F.V. Kondenstator ventilatori, 1 copë • F.V. Motori i ventilatorit, 1 copë • F.V. Sensor temperature, 2 copë • F.V. Pakete elektronike , 1 copë • F.V. Kompresori, 1 copë • F.V. Gaz refrigerant R 410, 6 kg • F.V. Veshje termoizoluese për tubacionet e bakrit, 3 ml Veprimet e zakonshme që duhen ndërrmarë gjatë mirëmbajtjes së kondicionerit • Verifikime dhe kontrole të linjës së shkarkimit të kondensatit, humbjeve ose rrjedhjeve në tubacione dhe rakorderi, gjenjes së termoizolimit të tubacioneve, sensorëve të ajrit dhe lagështirës, zhurmave dhe vibrimeve jo normale, i presionit të gazit, ventilatorëve, kompresorëve, temperaturave të punës kontakteve dhe releve elektrike, pllaketave elektronike, lidhjeve elektrike, valvulave të zgjerimit (cdo muaj) 12 sherbime • Pastrim dhe larje me solucion filtra ajri, vasketa kondensimi, tuba kondense, ventilator, serpentina, kondensator, shtrëngim i kontakteve elektrike, lubrifikim i pjesëve mekanike (cdo tre muaj), 4 sherbime • Kontroll periodik mujor, evidentim dhe raportim i defekteve të mundshme, zgjidhje teknike gjatë intervalit kohor 24/7
--	--	--	--

E	Kondicioner 18kBTU, tip “VIVAX Mural”	2 copë	Të dhënat e Kondicionerit: • Emërtimi: Kondicioner tip “Mural” • Prodhimi: VIVAX • Tensioni i punës: 220–240 V AC • Kapaciteti në ngrohje: 18,000 BTU/h $\approx$ 5.2 – 5.6 kW • Kapaciteti në ftohje: 18,000 BTU/h $\approx$ 5.0 – 5.3 kW • Lloji i gazit: R32 (ose R410A në disa versione) • Pesha e njësisë së brendshme: ~45–50 kg • Frekuenca: 50 Hz • Rrjedhja e ajrit brenda njësisë: >1000 m³/h (sipas manualit) • Niveli i zhurmës (njësia e brendshme): 35–45 dB • Vendodhja: Instaluar në sallën e TI në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Pjesë Këmbimi per kondicionerin: • F.V. Kondenstator kompresori, 1 copë • F.V. Kondenstator ventilatori, 1 copë
----------	--	--------	--

			• F.V. Motori i ventilatorit , 1 copë • F.V. Sensor temperature 2 copë • F.V. Pakete elektronike , 1 copë • F.V. Kompresori , 1 copë • F.V. Gaz refregerant R 410, 6 kg • F.V. Veshje termoizoluese për tubacionet e bakrit, 7ml Veprimet e zakonshme që duhen ndërmarrë gjatë mirëmbajtjes së kondicionerit: • Verifikime dhe kontrole të linjës së shkarkimit të kondensatit, humbjeve ose rrjedhjeve në tubacione dhe rakorderi, gjenjes së termoizolimit të tubacioneve, sensorëve të ajrit dhe lagështirës, zhurmave dhe vibrimeve jo normale, i presionit të gazit, ventilatorëve, kompresorëve, temperaturave të punës kontakteve dhe releve elektrike, pllaketave elektronike, lidhjeve elektrike, valvulave të zgjerimit (cdo muaj) 12 sherbime • Pastrim dhe larje me solucion filtra ajri, vasketa kondensimi, tuba kondense, ventilator, serpentina, kondensator, shtrëngim i kontakteve elektrike, lubrifikim i pjesëve mekanike (cdo tre muaj), 4 sherbime • Kontroll periodik mujor, evidentim dhe raportim i defekteve të mundshme, zgjidhje teknike gjatë intervalit kohor 24/7 • Instalimi dhe riparimi i pjesëve të këmbimit të dëmtuara, brenda koston së mirëmbajtjes • Kohëzgjatja: 12 muaj
--	--	--	---

F	Kondicioner 12kBTU, tip “Mural Idealclima“	1 copë	Të dhënat e Kondicionerit: • Emërtimi: Kondicioner tip “Mural” (Split) • Prodhimi: Idealclima • Tensioni i punës: 220–240 V AC • Kapaciteti në ngrohje: 12,000 BTU/h $\approx$ 2.9 – 3.8 kW • Kapaciteti në ftohje: 12,000 BTU/h $\approx$ 3.5 kW • Lloji i gazit: R32 (ose R410A në disa versione) • Pesha e njësisë së brendshme: ~12–15 kg • Frekuenca: 50 Hz • Rrjedhja e ajrit brenda njësisë: >600–700 m³/h (sipas manualit) • Niveli i zhurmës (njësia e brendshme): 30–40 dB • Kohëzgjatja: 12 muaj • Venddodhja: Instaluar në sallën e TI në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Pjesë Këmbimi per kondicionerin: • F.V. Kondensator kompresori, 1 copë • F.V. Kondensator ventilatori, 1 copë • F.V. Motori i ventilatorit, 1 copë • F.V. Sensor temperature, 2 copë • F.V. Pakete eleektronike 1 copë • F.V. Kompresori, 1 copë
----------	---	--------	--

			- F.V. Gaz refrigerant R 410, 3 kg - F.V. Veshje termoizoluese për tubacionet e bakrit, 4 ml Veprimet e zakonshme që duhen ndërmarrë gjatë mirëmbajtjes së kondicionerit: - Verifikime dhe kontrole të linjës së shkarkimit të kondensatit, humbjeve ose rrjedhjeve në tubacione dhe rakorderi, gjenjes së termoizolimit të tubacioneve, sensorëve të ajrit dhe lagështirës, zhurmave dhe vibrimeve jo normale, i presionit të gazit, ventilatorëve, kompresorëve, temperaturave të punës kontakteve dhe releve elektrike, pllaketave elektronike, lidhjeve elektrike, valvulave të zgjerimit (cdo muaj) 12 sherbime - Pastrim dhe larje me solucion filtra ajri, vasketa kondensimi, tuba kondense, ventilator, serpentina, kondensator, shtrëngim i kontakteve elektrike, lubrifikim i pjesëve mekanike (cdo tre muaj), 4 sherbime - Kontroll periodik mujor, evidentim dhe raportim i defekteve të mundshme, zgjidhje teknike gjatë intervalit kohor 24/7 - Instalimi dhe riparimi i pjesëve të këmbimit të dëmtuara, brenda koston së mirëmbajtjes - Kohëzgjatja: 12 muaj
--	--	--	---

G	Kondicioner 12kBTU, tip “Mural Haier”	2 copë	Të dhënat e Kondicionerit: - Emërtimi: Kondicioner tip “Mural” - Prodhimi: Haier - Tensioni i punës: 220–240 V AC - Kapaciteti në ngrohje: Në ngrohje shpesh del pak më i lartë sepse kondicioneri punon si pompë nxehtësie. - Kapaciteti në ftohje: 12,000 BTU/h $\approx$ 3.5 kW - Lloji i gazit: R32 (ose R410A në disa versione) - Pesha e njësisë së brendshme: ~12–15 kg - Frekuenca: 50 Hz - Rrjedhja e ajrit brenda njësisë: >600–700 m³/h (sipas manualit) - Niveli i zhurmës (njësia e brendshme): 30–40 dB. - Venddodhja: Instaluar në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit. Pjesë Këmbimi per kondicionerin: - F.V. Kondensator kompresori, 2 copë - F.V. Kondensator ventilatori, 2 copë - F.V. Motori i ventilatorit, 1 copë - F.V. Sensor temperature, 4 copë - F.V. Pakete elektronike 1 copë - F.V. Kompresori , 1 copë - F.V. Gaz refrigerant R 410, 3 kg - F.V. Veshje termoizoluese për tubacionet e bakrit, 6 ml
----------	--	--------	--

			Veprimet e zakonshme që duhen ndërmarrë gjatë mirëmbajtjes së kondicionerit: • Verifikime dhe kontrole të linjës së shkarkimit të kondensatit, humbjeve ose rrjedhjeve në tubacione dhe rakorderi, gjenjes së termoizolimit të tubacioneve, sensorëve të ajrit dhe lagështirës, zhurmave dhe vibrimeve jo normale, i presionit të gazit, ventilatorëve, kompresorëve, temperaturave të punës kontakteve dhe releve elektrike, pllaketave elektronike, lidhjeve elektrike, valvulave të zgjerimit (cdo muaj), 12 sherbime • Pastrim dhe larje me solucion filtra ajri, vasketa kondensimi, tuba kondense, ventilator, serpentina, kondensator, shtrëngim i kontakteve elektrike, lubrifikim i pjesëve mekanike (cdo tre muaj), 4 sherbime • Kontroll periodik mujor, evidentim dhe raportim i defekteve të mundshme, zgjidhje teknike gjatë intervalit kohor 24/7 • Instalimi dhe riparimi i pjesëve të këmbimit të dëmtuara, brenda koston së mirëmbajtjes • Kohëzgjatja: 12 muaj
--	--	--	--

H	Kondicioner 20kBTU, tip “Mural TelCom”	1 copë	Të dhënat e Kondicionerit: • Emërtimi: Kondicioner tip “Mural TelCom” • Prodhimi: TelCom • Tensioni i punës: 220-240 V AC • Kapaciteti në ngrohje: 20000 BTU/h ~ 5.8 kW • Kapaciteti në ftohje: 20000 BTU/h ≈ 5.8 kW • Lloji i gazit: R134a ose R422d • Peshë e njësisë së brendshme: 12-15 kg • Frekuenca: 50 HZ • Rrjedhja e ajrit brenda njësisë: ~100-300 m³/h (sipas manualit) • Niveli i zhurmës (njësia e brendshme): 40-55 dB • Venddodhja: Instaluar në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit. Pjesë Këmbimi per kondicionerin: • F.V. Kondensator kompresori, 1 copë • F.V. Kondensator ventilatori, 1 copë • F.V. Motori i ventilatorit, 1 copë • F.V. Sensor temperature, 2 copë • F.V. Pakete elektronike, 1 copë • F.V. Kompresori, 1 copë • F.V. Gaz refrigerant R 410, 3 kg • F.V. Veshje termoizoluese për tubacionet e bakrit, 3 ml Veprimet e zakonshme që duhen ndërmarrë gjatë mirëmbajtjes së kondicionerit: • Verifikime dhe kontrole të linjës së shkarkimit të kondensatit, humbjeve ose rrjedhjeve në tubacione dhe rakorderi, gjenjes së termoizolimit të tubacioneve, sensorëve të ajrit dhe lagështirës, zhurmave dhe vibrimeve jo normale, i presionit të gazit, ventilatorëve, kompresorëve, temperaturave të punës kontakteve
----------	---	--------	--

			dhe releve elektrike, pllaketave elektronike, lidhjeve elektrike, valvulave të zgjerimit (cdo muaj) 12 sherbime • Pastrim dhe larje me solucion filtra ajri, vasketa kondensimi, tuba kondense, ventilator, serpentina, kondensator, shtrëngim i kontakteve elektrike, lubrifikim i pjesëve mekanike (cdo tre muaj), 4 sherbime • Kontroll periodik mujor, evidentim dhe raportim i defekteve të mundshme, zgjidhje teknike gjatë intervalit kohor 24/7 • Instalimi dhe riparimi i pjesëve të këmbimit të dëmtuara, brenda koston së mirëmbajtjes • Kohëzgjatja: 12 muaj
--	--	--	---

I	Kondicioner 12kBTU tip “Mural Grey”	2 copë	Të dhënat e Kondicionerit: • Emërtimi: Kondicioner tip “Mural Grey” • Prodhimi: Grey • Tensioni i punës: 220-240 V AC • Kapaciteti në ngrohje: 13000 BTU/h $\approx$ 3.8 kW • Kapaciteti në ftohje: 12000 BTU/h $\approx$ 3.5 kW • Lloji i gazit: R134a • Peshë e njësisë së brendshme: 15-35 kg • Frekuenca: 50 Hz / 60 Hz • Rrjedhja e ajrit brenda njësisë: $\sim$100-300 m³/h (sipas manualit) • Niveli i zhurmës (njësia e brendshme): 50-60 db • Venddodhja: Instaluar në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit Pjesë Këmbimi per kondicionerin: • F.V. Kondensator kompresori, 1 copë • F.V. Kondensator ventilatori, 1 copë • F.V. Motori i ventilatorit, 1 copë • F.V. Sensor temperature, 2 copë • F.V. Pakete elektronike 1 copë • F.V. Kompresori , 1 copë • F.V. Gaz refrigerant R 410, 2 kg • F.V. Veshje termoizoluese për tubacionet e bakrit, 3 ml Veprimet e zakonshme që duhen ndërmarrë gjatë mirëmbajtjes së kondicionerit: • Verifikime dhe kontrolle të linjës së shkarkimit të kondensatit, humbjeve ose rrjedhjeve në tubacione dhe rakorderi, gjenjes së termoizolimit të tubacioneve, sensorëve të ajrit dhe lagështirës, zhurmave dhe vibrimeve jo normale, i presionit të gazit, ventilatorëve, kompresorëve, temperaturave të punës kontakteve dhe releve elektrike, pllaketave elektronike, lidhjeve elektrike, valvulave të zgjerimit (cdo muaj), 12 sherbime
----------	--	--------	---

			• Pastrim dhe larje me solucion filtra ajri, vasketa kondensimi, tuba kondense, ventilator, serpentina, kondenstator, shtrëngim i kontakteve elektrike, lubrifikim i pjesëve mekanike (cdo tre muaj), 4 sherbime • Kontroll periodik mujor, evidentim dhe raportim i defekteve të mundshme, zgjidhje teknike gjatë intervalit kohor 24/7 • Instalimi dhe riparimi i pjesëve të këmbimit të dëmtuara, brenda koston së mirëmbajtjes • Kohëzgjatja: 12 muaj
--	--	--	---

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

LOTI 2: “RIPARIM DHE MIRËMBAJTJE E SISTEMIT TË NGROHJE-FTOHJES NË SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Në Spitalin Universitar të Traumës janë të instaluar sistemet e mëposhtme: **Chiller, AHU (Air Handling Units)** të pajisura me filtra bakterologjikë, **Kondicionerë tip ON/OFF**, si dhe sisteme **VRF (Variable Refrigerant Flow)**, për të cilat kërkohet ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes periodike dhe riparimit, për një periudhë 24 (njëzet e katër) mujore.

Shërbimet do të realizohen në përputhje me standardet europiane dhe legjislacionin për gazrat ftohës, duke garantuar sigurinë, efikasitetin energjetik dhe funksionimin optimal të sistemeve HVAC. Shërbimet do të realizohen në ambientet e Spitalit Universitar të Traumës, në përputhje me zërat dhe specifikimet e detajuara në tabelat bashkëlidhur, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi Shërbimeve	Njësia	Sasia
	1-Sherbim dhe mirembajtje per Chillerat me kapacitet të ndryshëm ne Reanimacion Modeli Midea		
1	Kontroll i presionit të gazit, filtrit të ujit dhe të komponentëve elektrik për chillera, Pastrim dhe dezinfektim i serpentinave brenda dhe jashte dhe Kontroll i punes dhe parametrave te Chillerit nje herë në 6 (gjashte) muaj (cope 4x4 here ne 24 muaj)	copë	16
2	F.V Elektrovalve tre rrugësh për chillera me 2 dhe 6 motorë.	copë	1
3	F.V pakete elektronike per chiller	copë	1
4	F.V manometer presioni	copë	1
5	Riparim saldim tub bakri i Chillerit	copë	1
6	Riparim/Nderrim serpentine Njesi trajtimit te Ajrit	copë	1
7	Riparim Kompresor Çilleri	copë	1
8	F.V Kompresor Çilleri	copë	1
9	F.V ventilator çilleri, ndërrim elika	copë	1
10	F.V Shkembyes nxehtesie	copë	1
11	Riparim pakete elektronike elektropompe te furnizimit me uje	copë	1
12	Riparim Serpentine e Chillerit	copë	1
13	Riparim pompe qarkulluese chilleri	copë	1
14	Pastrimi dhe larje Cmontim /montim njesi e brendshme me solucion	copë	1
15	F.V termostati	copë	1
16	F.V Nderrim barometri (termo-manometer)	copë	1
17	F.V valvol sigurie	copë	1
18	F.V i leshuesve	copë	1
19	F.V kuadri elektrik Chilleri	copë	1
20	Riparim tuba kondensimi Fan- Coilesh	copë	1
21	F.V transformatori fan-coilesh	copë	1
22	F.V motorr ventilatori fan-coilesh	copë	1
23	F.V sensoresh fan-coilesh	copë	1
24	Riparim pakete komandimi fan-coilesh	copë	1
25	Riparim/nderrim saracineska Ø1"	copë	1
26	Riparim/nderrim buketon T- I, Ø1"	copë	1
27	Pastrim larje/zëvendësim i HEPA FILTRASH ne AHU 1 (një) here ne 3 (tre) muaj nga lidhja e kontratës (cope 6x8 here ne 24 muaj)	copë	48
28	F.V Filtra Antibakterial per AHU 1 (një) here ne 6 muaj (cope 6x4 here ne 24 muaj)	copë	24
29	F.V Ventilator per AHU	copë	1
30	Riparim Termoizolues për tubacione kondicionim AHU	ml	1
31	F.V i leshuesve AHU	copë	1
32	F.V Rrip per AHU	copë	1
33	F.V Kuzhuni per AHU	copë	1
34	F.V Inverter per AHU	copë	1
35	Kontroll i tubacioneve, eliminimi i rrjedhjeve Ø të ndryshëm për riparim (Izolim termik)	ml	1
36	Enë zgjerimi (expansion tank)	copë	1
37	F.V antifrizë 60%	litra	1
38	F.V Ajernxjerres	copë	1

	2- Sherbim dhe mirembajtje per VRF Kapaciteti termik ne Ftohje: Q = 135 kW,Kapaciteti termik ne Ngrohje: Q = 150 kW (1 cope ne Sherbimin e kirurgjise Kemba Diabetike) modeli Fujitsu.	Njësia	Sasia
1	Pastrim i serpentinës së njësisë së jashtme me solucion profesional antibakterial dhe dezinfektues, 1 (një) herë në Vit, gjithsej 8 (tetë) shërbime gjatë periudhës 24 mujore	copë	8
2	Pastrim dhe kontroll i motorëve të ventilatorëve të jashtëm, përfshirë lubrifikimin kur lejohet nga prodhuesi	copë	1
3	Kontroll i balancimit të ventilatorëve dhe eliminimi i vibrimeve	set	1
4	Matjen e presioneve të punës	copë	1
5	Kontrollin e temperaturave operative	copë	1
6	Kontrollin e parametrave të vajit (kur është e aplikueshme)	copë	1
7	Kontroll dhe testim i presostatëve të presionit të ulët dhe të lartë (nëse sistemi është i pajisur me to)	copë	1
8	Kontroll i rrjedhjeve të gazit me detektor elektronik profesional	copë	1
9	Kontroll i parametrave të performancës së sistemit dhe optimizim i punës	copë	1
10	Pastrim i serpentinës së brendshme me solucion profesional antibakterial	copë	1
11	Pastrim i ventilatorëve dhe turbinave të njësive të brendshme	copë	1
12	Kontroll i motorëve të ventilatorëve të brendshëm	copë	1
13	Kontroll i pompave të drenazhit dhe sistemit të kondensimit	copë	1
14	Kontroll i funksionimit të kompresorëve inverter	copë	1
15	Kontroll dhe kalibrim i valvulave elektronike të ekspansionit	total	1
16	Kontroll i komunikimit BUS ndërmjet njësive të brendshme dhe të jashtme	cope	1
17	Kontroll i PCB-ve dhe sinjaleve të komunikimit	cope	1
18	Testim i sensorëve të temperaturës dhe presionit	cope	1
19	Konstatim defekti, riparim dhe testim funksional të sistemit VRF	cope	1
20	F.V Kompresorëve inverter	cope	1
21	F.V Motorëve të ventilatorëve	cope	1
22	F.V Valvulave elektronike	cope	1
23	F.V PCB dhe komponentëve elektronikë	cope	1
24	F.V Sensorëve dhe presostatëve	cope	1
25	Çmontim, montim dhe avolxhim i motorëve të ventilatorëve	cope	1
26	Riparim tubacionesh dhe izolimi termik	ml	1
27	F.V Valvul të sistemit të qarkullimit të gazit	copë	1
28	F.V Termostate murale per fan-coile	copë	1
29	F.V lëshues elektromagnetik 63A	copë	2
	Paisje te brendshme kondicionimi tipi VRF		
28	Pastrim serpentine e brendshme me solucion perkates cdo 6 muaj (cope70x4 here ne 24 muaj)	copë	280
29	Kontroll i tubacioneve, eleminimi i rrjedhjeve Ø të ndryshëm për riparim (Izolim termik)	ml	1
30	F.V Valvul presioni	copë	1
31	Pastrim dhe larje filtra 1 (nje) here ne 3 (tre) muaj. (cope70x8 here ne 24 muaj)	copë	560
	3- Sherbim dhe mirembajtje per Chillerat me kapacitet të ndryshëm ne Sherbimin e Kirurgjise Kemba Diabetike modeli Cooper&Hunter	Njësia	Sasia
1	Kontroll i presionit të gazit, filtrit të ujit dhe të komponentëve elektrik për chillera, Pastrim dhe dezinfektim i serpentinave brenda dhe jashte dhe Kontroll	copë	16

	i punes dhe parametrave te Chillerit nje herë në 6 (gjashte) muaj (cope 4x4 here ne 24 muaj)		
2	F.V Elektrovalve tre rrugësh për chillera me 2 dhe 6 motorë.	copë	1
3	F.V pakete elektronike per chiller	copë	1
4	F.V manometer presioni	copë	1
5	Riparim saldim tub bakri i Chillerit	copë	1
6	Riparim/Nderrim serpentine Njesi trajtimit te Ajrit	copë	1
7	F.V Motorr – Kompresor 45 kW- 60 kW	copë	1
8	F.V ventilator çilleri, ndërrim elika	copë	1
10	Riparim pakete elektronike elektropompe te furnizimit me uje	copë	1
11	Riparim Serpentine e Chillerit	copë	1
12	Riparim pompe qarkulluese chilleri	copë	1
13	Pastrimi dhe larje Cmontim /montim njesi e brendshme me solucion	copë	1
14	F.V termostati	copë	1
15	F.V Nderrim barometri (termo-manometer)	copë	1
16	F.V valvol sigurie	copë	1
17	F.V i leshuesve	copë	1
18	F.V kuadri elektrik Chilleri	copë	1
19	F.V motorr ventilatori fan-coilesh	copë	1
20	F.V sensoresh fan-coilesh	copë	1
21	Riparim pakete komandimi fan-coilesh	copë	1
22	Riparim/nderrim saracineska Ø1"	copë	1
23	Riparim/nderrim buketon T- I, Ø1"	copë	1
24	Pastrim larje/zëvendësim i HEPA FILTRASH ne AHU 1 (një) here ne 3 (tre) muaj nga lidhja e kontratës (cope3x8 here ne 24 muaj)	copë	24
25	F.V Filtra Antibakterial per AHU 1 (një) here ne 6 muaj (3 cope x 4 here ne 24 muaj)	copë	12
26	F.V Ventilator per AHU	copë	1
27	Riparim Termoizolues për tubacione kondicionim AHU	ml	1
28	F.V i leshuesve AHU	copë	1
29	F.V Rrip per AHU	copë	1
30	F.V Kuzhuniet per AHU	copë	1
31	F.V Inverter per AHU	copë	1
32	Kontroll i tubacioneve, eliminimi i rrjedhjeve Ø të ndryshëm për riparim (Izolim termik)	ml	1
33	Enë zgjerimi (expansion tank)	copë	1
34	F.V Saraçineske me leve 3"	copë	1
35	F.V Saraçineske me leve 1 1/4	copë	1
36	F.V Nipla	copë	1
37	F.V Hollandez 1 1/4	copë	1
	4-Paisje e jashtme kondicionimi (tipi VRF kapacitet 33 kw-60 kw), (ne Godinen e SB1/SB2 te rikonstruktuar) modeli Mitsubishi Heavy Industries	Njësia	Sasia
1	Pastrim serpentine e jashtme me solucion perkates, cdo 6 muaj (9 cope x 4 here ne 24 muaj)	copë	36
2	Pastrim dhe vajtise te motorrit te helikes se jashtme cdo 6 muaj (9 cope x 4 here ne 24 muaj)	copë	36
3	Shpëlarje e tubacioneve me azot vetëm në rast ndërhyrjeje teknike, ndërrimi kompresori ose kontaminimi të sistemit.	copë	1

4	Riparim pakete sistemi VRF	copë	1
5	F.V Motorr – Kompresor 33 kW- 60 kW	copë	1
6	Nderrim leshues sipas nevojës	copë	1
7	Konstatim defekti, testim	copë	1
8	F.V Pakete e brendshme per VRF	copë	1
9	Kontroll i tubacioneve, eleminimi i rrjedhjeve Ø të ndryshëm për riparim (Izolim termik)	copë	1
10	F.V Njësi kompresorësh spiral për sisteme VRF / ajër të kondicionuar dhe pompa nxehtësie	copë	1
11	F.V valvol sigurie mbi 5 bar	copë	2
12	F.V T- I bakri 2"	copë	2
13	F.V T- I plastik 2"	copë	2
14	F.V Tuba plastik 2"	ml	5
15	F.V Tuba plastik ϕ 1"	ml	5
16	F.V Ç`ajrus automatik ne fund telinjes	copë	4
17	F.V Elektrovalvol VE 120 4R Mo PD 30 bar	copë	2
18	F.V Sensor presioni VRF	copë	1
	Sistemi i Aspirimit dhe Ventilimit		
11	Kontroll periodik i funksionimit të ventilatorëve (10 cope x 4 here ne 24 muaj)	copë	40
12	Pastrim dhe/ose zëvendësim i filtrave çdo 3 muaj (8cope x 8 here ne 24 muaj)	copë	64
13	Pastrim i kanaleve të ajrit	copë	1
14	Kontroll i motorëve elektrikë	copë	1
15	Kontroll i grilave	copë	1
16	Kontroll i paneleve të komandimit	copë	1
17	Kontroll i rrjedhës së ajrit	copë	1
	Paisje e brendshme kondicionimi (tip casete, duct dhe split 3.5KW-6.5 KW), copë 219		
18	Pastrim dhe larje filtra 1 (nje) here ne 3 (tre) muaj (219 cope x 8 here ne 24 muaj)	copë	1752
19	Pastrim serpentine e brendshme me solucion perkates	copë	1
20	Pastrim i helikes se brendshme me solucion perkates	copë	1
21	Cmontim, riparim,montim motori i helikes se brendshme	copë	1
22	Cmontim, montim avolxhim motori i helikes se brendshme	copë	1
23	Kontroll i tubacioneve, eleminimi i rrjedhjeve Ø të ndryshëm për riparim (Izolim termik)	copë	1
24	Nderrim kondestator kondicioneri	copë	1
25	Nderrim sensor kondicioneri	copë	1
26	F.V kondesate kondicioneri	copë	1
27	F.V Pult i avancuar me prekje	copë	1
28	Kontroll i tubacioneve, eleminimi i rrjedhjeve Ø të ndryshëm për riparim (Izolim termik)	copë	1
29	F.V Kompresor TIPI: Copeland Scroll	copë	1

	5.-Kondicioner ON/OFF dhe INVERTER (9-32) btu/h (108 Cope)	Njësia	Sasia
1	Kontroll i presionit të gazit për kondicionerët	copë	1
2	Pastrim dhe larje njesi e brendshme me solucion 9, 12, 18, 24, 32, BTU “larje serbetina”	copë	1
3	Pastrim dhe larje filtra te kondicionerev 1 (nje) here ne 6 (gjashte) muaj. (4x108 Cope)	copë	432
4	Çmontim/montim i kondicionerëve nga një ambient në një ambient tjetër	copë	1
5	Riparim defektesh të paparashikuara, çarje tubi, rrjedhje gazi	copë	1
6	Kontroll i tubacioneve, eliminimi i rrjedhjeve Ø të ndryshëm për riparim	copë	1
7	Riparim/zevendësim pakete kondicioneri të ndryshëm për fuqi nga 9 deri 32 BTU.	copë	1
8	Konstatim defekti, riparim, proces pune me azot , testim pajisje mono-split, ftohje/ngrohje 2.8 / 3.2 kW, sasia e ajrit max/min: 370/500 m3/h	copë	1
9	F.V Termoizolim per tubacione kondicionimi	ml	1
10	F.V Sensor temperature i brendshem	copë	1
11	F.V. kondestator per njesi te jashtme	copë	1
12	F.V Sensor temperature i jashtem	copë	1
13	F.V Elektrovalve tre rrugësh kondicioner 9-12-24-32 BTU.	copë	1
14	F.V Helike ventilatori të ndryshme.	copë	1
15	F.V Gaz R 410 A	kg	50
16	F.V Kompresor 9-12-24-32 BTU sipas nevojës qe do te lindi gjatë punës.	copë	2
17	F.V motorri (fryrësi) 2.5 KW	copë	2
18	F.V Pult kondicioneri (te ndryshem)	copë	5
19	F.V filtra ajri per kondicionere te ndryshem	copë	5
20	F.V tuba bakri kondicioner 9000-32000 BTU	ml	5
21	F.V kabllo elektrike 4*2,5 mm2	ml	5

Shënim:

Sasitë janë parashikime për shërbimet e mundshme qe mund te nevojiten gjatë periudhës 24 mujore. Sasitë e dhëna këtu janë vetëm për qëllime orientimi dhe NUK e detyrojnë Autoritetin Kontraktor t'i blejë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara.

